

Sa ka kapacitete
Kosova të pranojë
refugjatë? | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PREJ 9 581 TESTIMEVE, 1 765 QYTETARË KANË REZULTUAR POZITIVË ME COVID
DHE JANË SHËNUAR EDHE PESË RASTE TË VDEKJES | FAQE 4-5

RRITJE E MADHE E RASTEVE ME COVID, KËRKOHEN QENDRA TË VAKSINIMIT NË FSHATRA



Shifrat e infektive me Covid-19 të martën kanë thyer çdo rekord që nga fillimi i pandemisë. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë regjistruar 1 765 raste të reje të infektimit me koron-

avirus dhe kanë vdekur edhe pesë persona. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka mbledhur krerët e institucioneve shëndetësore për të diskutuar ndërmarrjen e masave të reja kundër Covidit. Shoqëria civile

dhe opozita kanë ftuar qeverinë që ta ndërrojë qasjen e vaksinimit të qytetarëve, duke kërkuar vendosje të qendrave për vaksinim nëpër fshatra dhe formim të ekipeve mobile për vaksinim në zona të thella

ShBA-ja
thotë se
Kosova
tregoi
leadership me
vendimin
për afganët
| FAQE 3



94 subjekte politike kanë
aplikuar për zgjedhjet
lokale të 17 tetorit | FAQE 7



MËRGIMTARËT NË KOSOVË, NË
DY JAVËT E PARA TË GUSHTIT
ERDHËN 738 AEROPLANË | F. 8

KURTI: SUKSESI I KEK-UT,
PARAKUSHT PËR ZHVILLIM
EKONOMIK | F. 8

SPORT



PËRFUNDON AFATI KALIMTAR
NË BASKETBOLL | F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ambasadorja Kim: Ende nuk e dimë se sa afganë do të strehohen në Shqipëri



TIRANË, 17 GUSHT - Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, Yuri Kim, tha se ende nuk e dinë numrin e saktë të afganëve që do të strehohen në Shqipëri ose kur do të arrijnë ata. "Nuk kemi numër të saktë. Po ndryshon shumë shpejt (situata). Ajo që mund të them është se njerëzit do të vijnë këtu përkohësisht dhe ideja është që më pas të shkojnë në Shtetet e Bashkuara, ku do të vendosen përfundimisht", tha të martën ambasadorja Yuri Kim, pas një takimi që zhvilloi me ministrin e

Jashtme shqiptare, Olta Xhaçka. Ambasadorja Kim shprehu falënderimin e saj për popullin dhe Qeverinë e Shqipërisë që kanë vendosur t'i strehojnë afganët që kanë bashkëpunuar me ShBA-në, pasi talebanët kanë deklaruar se kanë marrë nën kontroll Afganistanin. Talebanët kanë deklaruar se Afganistani është në kontrollin e plotë të tyre, pasi ata morën pallatin presidencial më 15 gusht, vetëm pak orë pasi presidenti Ashraf Ghani iku nga vendi. Militantët islamikë nuk hasën në rezistencë derisa

rimorën kontrollin, dy dekada pasi u rrëzuan nga forcat e huaja, të udhëhequra nga ShBA-ja. Në aeroportin e Kabulit të hënën kanë shpërthyer skena kaotike, pasi qindra njerëz përpqeshin të iknin nga vendi. Departamenti Amerikan i Shtetit ka shpallur një program të ri i cili u mundëson mijëra afganëve mundësinë të zhvendosjen si refugjatë në ShBA. Mijëra afganë që do të jenë pjesë e këtij programi duhet të barten në një shtet të tretë dhe të presin për 12 deri në 14 muaj derisa të analizohet gjithë aplikacioni.

Stoltenberg paralajmëron talebanët të mos kthejnë Afganistanin në strehë për terroristë

BRUKSEL, 17 GUSHT - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka paralajmëruar talebanët se aleanca nuk do të lejojë që Afganistani të bëhet strehë për terrorizëm, pasi militantët kanë marrë pushtetin në fundjavë. "Ata që tani marrin pushtetin, kanë përgjegjësi për të siguruar se terroristët ndërkombëtarë të mos fitojnë terren", ka thënë Stoltenberg në një konferencë për media në Bruksel më 17 gusht. Ai ka thënë se ndonëse NATO-ja ka tërhequr

forcat nga Afganistani, aleanca do të mbetet në vëzhgim nëse ka shenja që grupet terroriste janë duke u rigrupuar, apo nëse mund të ketë sulme nga distanca. Stoltenbergu ka thënë se NATO-ja është befasuar nga shpejtësia e fitores së talebanëve, mirëpo ka fajësuar liderët afganë për shtrirje të "tragjedisë" duke përkrahur deklaratën e një dite më parë të presidentit amerikan, Joe Biden. "Një pjesë e forcave afgane të sigurisë kanë luftuar

trimërisht, mirëpo ato nuk kanë mundur ta sigurojnë shtetin sepse udhëheqësia politike afgane ka dështuar që të përballet me talebanët dhe të arrijë zgjidhje paqësore, të cilën afganët e kanë kërkuar aq shumë. Ky dështim i udhëheqësive afgane ka çuar në tragjedinë që jemi duke e parë", ka shtuar Stoltenberg, duke theksuar se qëllimi i NATO-s ka qenë që të ndërtojë një shtet të menaxhuar dhe jo të ketë prani të përhershme aty



ShBA-ja e shqetësuar me prodhimin e metalit të uranimit në Iran



WASHINGTON, 17 GUSHT - Shtetet e Bashkuara janë të shqetësuara me raportin e fundit të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Bërthamore (IAEA) në lidhje me prodhimin e metalit të uranimit nga ana e Iranit. Departamenti Amerikan i Shtetit tha më 16 gusht se Shtetet e Bashkuara kanë parë raportin e fundit nga IAEA, sipas të cilit, Irani ka bërë përparim në pasurimin e uranimit. "Irani nuk ka nevojë të arsyeshme për të prodhuar metal uranimit, i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me zhvillimin e armëve bërthamore", tha përmes një deklarate zëdhënësi i

Departamentit të Shtetit të ShBA-së, Ned Price, duke i bërë thirrje Teheranit që ta ndalë programin e tij bërthamor dhe të kthehet në negociatë për zbatimin e marrëveshjes së vitit 2015. Metali i uranimit mund të përdoret për ta ndërtuar thelbin e një bombe bërthamore. Por, Irani tha në fillim të këtij viti se po studion metalin e uranimit për një lloj të ri të karburantit për reaktorin e energjisë. Sipas marrëveshjes bërthamore të Iranit me fuqitë botërore të vitit 2015, e njohur si Plani i Përbashkët Gjithëpërfshirës i Veprimt (JCPOA), Teherani u

zotua se nuk do të prodhojë metal uranimit. Por, ky vend shkeli atë premtim si një nga shumë veprimet që ndërmori pasi ish-presidenti amerikan, Donald Trump, tërhoqi Shtetet e Bashkuara nga marrëveshja dhe rivendosi sanksionet. Trump pati thënë se marrëveshja ishte e negociuar keq dhe se ajo i mundësonte Iranit që të posedojë armë bërthamore. Presidenti i ShBA-së, Joe Biden, ka thënë se dëshiron të kthehet në marrëveshje, por bisedimet indirekte në Vjenë, të ndërmjetësuara nga evropianët për të ringjallur marrëveshjen, kanë ngecur.

Vetëm tri ambasada po veprojnë në Kabul

KABUL, 17 GUSHT - Në kryeqytetin Kabul të Afganistanit po veprojnë vetëm tri ambasada të huaja, e Rusisë, Kinës dhe Pakistanit. Të gjitha vendet e tjera kanë evakuuar personelin e

ambasadave të tyre. Vendi i fundit që tërhoqi stafin ishte India. "Duke marrë parasysh rrethanat është vendosur që ambasadori ynë në Kabul dhe stafi i tij të zhvendosen menjëherë në Indi", ka pohuar

zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme indiane, Arimdam Bagchi, në "Twitter", më 17 gusht. Njoftimi vjen derisa mijëra afganë po përpqeshin me çdo kusht të largohen nga Kabuli

pasi qyteti u mor nën kontroll nga talebanët. Departamenti i Mbrojtjes i ShBA-së ka njoftuar se aeroporti i Kabulit ishte rihapur pasi fluturimet ishin ndaluar një ditë më parë për shkak të situatës së sigurisë.



Sa ka kapacitete Kosova për të pranuar refugjatë?

PRISHTINË, 17 GUSHT - Institucionet e Kosovës janë deklaruar se janë duke bërë përgatitjet e duhura logjistike e teknike, por edhe të sigurisë dhe sociale për strehimin dhe mbrojtjen e qytetarëve nga Afganistani.

Shtetet e Bashkuara kanë kërkuar nga Kosova që të pranojnë një pjesë të punëtorëve afganë që kanë punuar me forcat e huaja, mirëpo që tash ndihen të pasigurt pasi vendi është marrë nën kontrollin e talebanëve.

Deri më tani ende nuk dihet se sa do të jetë numri i afganëve që do të qëndrojnë në Kosovë derisa t'u përfundojnë procedurat e vizave amerikane.

Qeveria e Kosovës ka miratuar kërkesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme për dhënien e mbrojtjes së përkohshme dhe të menjëhershme personave të rrezikuar nga konflikti i brendshëm në Afganistan.

Kryeministri Albin Kurti tha të

martën se detajet e strehimit të qytetarëve të Afganistanit në Kosovë janë duke u diskutuar me Shtetet e Bashkuara.

Ekipi nga Kosova, i përbërë nga ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla dhe shefi i kabinetit të kryeministrit, Luan Dalipi, tha Kurti, janë duke diskutuar me partnerët dhe aleatët amerikanë lidhur me çështjen e strehimit të afganëve. "Kosova ka SHBA-në aleaten kryesore dhe partneren strategjike të pazëvendësueshme. Çështja e strehimit të refugjatëve nga Afganistani, përveç aspektit të solidaritetit humanist nga ana jonë, ka gjithashtu dimensionin e aleancës dhe partneritetit me ShBA-në. ShBA-ja na ka mbështetur dhe përkrahur në vazhdimësi dhe kjo është vetëm një pjesë e vogël e kontributit tonë përkundër ndihmës dhe mbështetjes së madhe për popullin tonë", tha Kurti.

"Radio Evropa e Lirë" ka

kontaktuar Qeverinë e Kosovës për të marrë detaje rreth vendit të strehimit të qytetarëve afganë në Kosovë, numrit të mundshëm të qytetarëve afganë që pritet të strehohen, por edhe kapaciteteve që ka Kosova. Megjithatë, ata nuk kanë ofruar informacione.

Kosova ka dy qendra të azilkërkuesve, një në Magurë të Lipjanit dhe një në fshatin Vranidoll të komunës së Prishtinës. Këto dy qendra kanë kapacitet të vogël dhe në kushte optimale mund të pranojnë jo më shumë se deri në 100 persona.

Si vend i mundshëm i strehimit është përmendur Parku i Inovacionit dhe i Trajnimeve në Prizren, i cili në të kaluarën kishte shërbyer si kamp ushtarak gjerman. Ish-kampi ushtarak gjerman ka një sipërfaqe prej 40 hektarësh dhe 52 ndërtesa.

"Radio Evropa e Lirë" ka kontaktuar përfaqësues nga Agjencia Gjermane për

Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) të cilët bëjnë menaxhimin dhe zhvillimin e Parkut. Ata nuk janë prononcuar për këtë temë duke thënë se është çështje bilaterale në mes të Qeverisë së Kosovës dhe ShBA-së.

"Radio Evropa e Lirë" i është drejtuar me pyetje Ministrisë së Punëve të Brendshme për të parë kapacitetin e qendrave të mundshme ku mund të strehohen qytetarët afganë, por nuk u janë përgjigjur pyetjeve tona.

Në anën tjetër, Izmi Zeka, ish-zëvendësministër i Punëve të Brendshme, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" tregon se në kohën kur ai ishte në këtë ministri në vitin 2019, kanë punuar për adaptimin e disa objekteve për refugjatë. Me adaptimin e këtyre objekteve dhe me dy qendrat e azilkërkuesve, Zeka thotë se Kosovë ka kapacitet për strehim të refugjatëve jo më shumë se 3 500 persona. "Unë

besoj që Kosova duhet t'i ketë përfunduar punët rreth disa objekteve që kanë qenë në adaptim e sipër dhe besoj që në kushte optimale deri në 3 500 persona do ta ketë mundësinë t'i pranojë. Kjo është llogaritur në raste të jashtëzakonshme", thotë ai. Kosova, shton Zeka, me kapacitetet e saj mund të pranojë refugjatë, por jo për kohë të gjatë, por të shkurtër, si vend transit dhe pastaj në bashkëpunim me Bashkimin Evropian apo Shtetet e Bashkuara të vendoset për më tutje.

Në vitin 2017, kur Kosova filloi të presë numër të refugjatëve nga vendet e Lindjes së Mesme, autoritetet në atë kohë patën deklaruar se kishin një plan dhe ishin të gatshme të strehonin më shumë se 3 000 refugjatë, nëse paraqitet nevoja.

Kosova nuk ka pasur numër të madh të refugjatëve, por vendi kryesisht përdoret si transit për në vende të ndryshme të Evropës.



ShBA-ja thotë se Kosova tregoi leadership me vendimin për afganët

PRISHTINË, 17 GUSHT - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) ka falënderuar Kosovën për gatishmërinë që të ofrojë strehë për afganët që kanë bashkëpunuar me forcat amerikane gjatë misionit gati 20-vjeçar në Afganistan. "Falënderimet e mia më të thella në emër të Shteteve të

Bashkuara për qeverinë dhe popullin e Kosovës për gatishmërinë tuaj që t'u ofroni strehë partnerëve tanë afganë në udhëtimin e tyre drejt një jete të re. Edhe një herë Kosova tregon leadership në nivel global", ka shkruar në rrjetin social "Twitter" ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett.

Të hënën presidenti amerikan Joe Biden tha se operacioni i largimit të personelit amerikan dhe punëtorëve afganë është duke vazhduar dhe se iu kanë dërguar mesazh talebanëve që nëse e pengojnë këtë operacion, do të përballen me përgjigje të shpejtë dhe të ashpër.





PREJ 9 581 TESTIMEVE, 1 765 QYTETARË KANË REZULTUAR POZITIVË ME COVID DHE JANË SHËNUAR EDHE PESË RASTE TË VDEKJES

Rritje e rasteve me Covid, kërkohen qendra të vaksinimit në fshatra

Shifrat e infektiveve me Covid-19 të martën kanë thyer çdo rekord që nga fillimi i pandemisë. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë regjistruar 1 765 raste të reja të infektimit me koronavirus dhe kanë vdekur edhe pesë persona. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka mbledhur krerët e institucioneve shëndetësore për të diskutuar ndërmarrjen e masave të reja kundër Covidit. Shoqëria civile dhe opozita kanë ftuar qeverinë që ta ndërrojë qasjen e vaksinimit të qytetarëve, duke kërkuar vendosje të qendrave për vaksinim nëpër fshatra dhe formim të ekipeve mobile për vaksinim në zona të thella

Arben Vitia, të thërrasë në takim krerët e institucioneve shëndetësore për të diskutuar rreth gjendjes së pandemisë në vend. Në komunikatën për media të Ministrisë së Shëndetësisë është thënë se në këtë takim pritet të diskutohet edhe për vendosjen e masave të reja për parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid-19.

Me paraqitjen e variantit "Delta" dhe rritjen e numrit të rasteve me Covid-19, "Democracy Plus" ka publikuar raportin me krahasimin e numrave të rasteve me variantin "Delta" në vendet si: Francë, Lituani, Luksemburg, Mal të Zi, Maqedoni e Veriut, Shqipëri dhe Serbi. Nga ky raport, "Democracy Plus" ka dhënë disa rekomandime për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin Kombëtar të

Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) për motivimin/nxitjen e qytetarëve për t'u vaksinuar. Disa nga rekomandimet janë: vendosja e qendrave për vaksinim në fshatra, pasi jo të gjithë qytetarët e kanë mundësinë t'i frekuentojnë qendrat kryesore të vaksinimit; të formohen ekipe mobile për vaksinim në zonat më të thella dhe të pacientët më të moshuar; vaksinimi për mësuesit/et, punëtorët/et e marketeve, personeli në bizneset e hotelierisë, shoferëve/eve të autobusëve dhe taksive të bëhet i obliguar, pasi këto janë kategoritë që kanë kontakte të drejtpërdrejta me qytetarët; të organizohen debate publike dhe emisione televizive me ekspertë shëndetësorë për ta shpjeguar efikasitetin e vaksinës dhe të jenë të hapura

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 17 GUSHT - Kosova ka shënuar të martën rekord të zi sa iu përket rasteve pozitive me Covid-19. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë regjistruar 1 765 raste të reja të infektimit me Covid-19 dhe kanë vdekur pesë persona. "Prej 9 581 testimeve, 1 765 qytetarë kanë

rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar 5 raste të vdekjes. Sot janë shënuar 121 qytetarë, kurse numri i përgjithshëm i të shënuarve është 106 278. Në total numri i rasteve aktive është 10 183" është thënë në njoftimin e ministrisë.

Gjithashtu, Ministria e Shëndetësisë ka treguar edhe për numrin e vaksinave kundër

Covidit që janë dhënë në 24 orët e fundit. "Në 24 orët e fundit janë dhënë 21 903 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 601 701 doza të vaksinës. Deri më sot 213 279 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Shëndetësisë. Rritja e rasteve ka shtyrë ministrin e Shëndetësisë,



për pyetje nga publiku; dhe vaksinimi të vazhdojë edhe gjatë fundjavës, në mënyrë që të ofrohen më shumë mundësi për vaksinim nga qytetarët. Ndaj numrit të madh të rasteve ka reaguar edhe ish-ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, duke e kritikuar qeverinë për menaxhim të keq të pandemisë. Ai ka vlerësuar se grumbullimi i madh i qytetarëve para qendrave të vaksinimit po ndikon që këto qendra të shndërrohen në shpërndarëse të infeksionit. “Dërgimi në rrugën e infeksionit e joparandalimit me vaksinë. Çka është ky, menaxhim? Jo! Ky është tmerr. Derisa qendrat e vaksinimit po shndërrohen në shpërndarëse të infeksionit, sikurse pamjet e sotme në Prizren e Gjakovë, ku edhe ashtu kemi rritje enorme

brenda ditësh të rasteve spitalore e, fatkeqësisht, edhe numri i vdekjeve po rritet frikshëm. Qeveria Kurti dhe ‘Mindil Vitia’ s’kanë as plan dhe as zgjidhje për ruajtjen e shëndetit të qytetarëve dhe jetës së tyre. Kjo qeveri ka hall tjetër, luksin e zyrave të qeverisë, agjendën populiste për vota dhe fushatën zgjedhore. Normalisht, edhe po bëjnë ‘praktikë’, me pushtet dhe me shëndet!”, ka shkruar Zemaj në profilin e vet në “Facebook”.

Edhe ish-kryeministri Avdullah Hoti ka reaguar ndaj shifrave të fundit. Ai ka paralajmëruar se me këto shifra shumë shpejt spitalet do të mbushen me pacientë. “Sipas praktikës, me këtë shifër ditore të rasteve të reja, pas disa dite spitalet tona do të jenë të mbushur me

pacientë. Është në dorën tonë ta parandalojmë përkeqësimin e situatës. Jeta është mbi të gjitha, para çdo ahengu apo ceremonie tjetër. Jeta jonë dhe e familjarëve e miqve tanë varet nga veprimet tona. Është e qartë se jemi larg përfundimit të pandemisë. Është e qartë se pandemia nuk është nën kontroll, siç deklaroni përgjegjësit për menaxhimin e pandemisë që, në kundërshtim me çdo normë morale, citonin shifrat e të infektuarve dhe vdekjeve kur e morën mandatin me shifrat pas 100 dite të qeverisjes. Ju patëm thënë atëherë se nuk bëhet politikë me pandemi. Ju themi edhe sot”, ka shkruar Hoti në profilin e vet në “Facebook”. Ai i ka ftuar qytetarët e Kosovës që t’i respektojnë masat anti-Covid. “Masat duhen

respektuar. Udhëzimet e IKSHIP-së duhet të merren seriozisht. Me sjellje të kujdesshme ne e mbrojmë familjen dhe miqtë nga infektimi. Nuk na mbrojnë masat e qeverisë si të tilla, sado strikte që të jenë ato, edhe nëse mbushet rruga me inspektorë e policë në mbikëqyrje të masave. Na mbron sjellja jonë për respektim të atyre masave në ambientet ku jetojmë, punojmë e lëvizim çdo ditë”, ka shkruar Hoti, duke ftuar institucionet shëndetësore të përgatiten. “Klinikat duhet të përgatiten për pacientët e mundshëm, siç kanë qenë në kohën e ministrit Zemaj. Furnizimi me oksigjen dhe barna për trajtim të rasteve me Covid-19 duhet të jetë i plotë për pacientët spitalorë dhe ata në shtëpi. Ekipet mjekësore dhe infermierët e

angazhuar nga ministri Zemaj duhet të kthehen në punë dhe të jenë në gjendje gatishmërie. Ekipet inspektuese në terren në bashkëpunim me komuna duhet të jenë plotësisht aktivë në dy ndërrime”, ka shkruar ai. Numri i infektimit të qytetarëve me Covid-19 është rritur në mënyrë të frikshme kohën e fundit në Kosovë.

Vetëm brenda një muaji në Kosovë janë regjistruar 10 085 raste të reja me Covid.

Më 17 korrik numri i rasteve aktive ka qenë 98, kurse të martën, më 17 gusht, Ministria e Shëndetësisë ka treguar se numri i rasteve aktive ka arritur në 10 183.

Prej 13 marsit të vitit 2020 deri më tani Kosova ka regjistruar 118 752 raste me Covid-19, prej tyre 2 286 kanë përfunduar me fatalitet.

Nxënësit në Maqedoninë e Veriut kthehen në shkolla



SHKUP, 17 GUSHT - Nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme në Maqedoninë e Veriut vitin e ri shkollor në shtator do ta nisin me prani fizike. Vendimi i qeverisë u mor me kërkesë të Ministrisë së Arsimit dhe rekomandim të shtabit qendror të krizës për menaxhim të pandemisë. Vendimi përjashtoi nxënësit me sëmundje kronike ose që kanë një anëtar të familjes me një sëmundje

kronike.

Mësimi online do të ndiqet nga nxënësit që do të jenë në izolim. “Nga shtatori mësimi do të nisë me prani fizike. Procesi mësimor do të vazhdojë derisa të lejojë gjendja epidemiologjike dhe në rast të përkeqësimit të saj, ne do të kalojmë në modelet e tjera që kemi në dispozicion. Vitin e kaluar ne treguam se mund të kemi një vit shkollor të suksesshëm online, por nuk ka

arsimim më të mirë sesa ai me prani fizike sepse përvojat si në botë ashtu edhe në vendin tonë tregojnë se shëndeti mendor dhe socializimi janë pjesë e të mësuarit. Shkollat tashmë janë trajnuar, ka protokolle, vitin e kaluar ato ishin të hapura për nxënësit më të vegjël dhe ne nuk kishim ndonjë përhapje të virusit. Prandaj, për këtë vit, në interes të nxënësve”, ka deklaruar ministria e Arsimit,

Milla Carovska.

Por, mësimi online ishte kritikuar në vazhdimësi nga nxënësit, prindërit dhe shoqatat e mësimdhënësve duke e vlerësuar si të dështuar për shkak të mospajisjes së një platforme të përbashkët, mungesës së internetit dhe pajisjeve në shumë shkolla. Ndërkohë, ministria e Arsimit, Carovska, u ka bërë thirrje mësuesve që të vaksinohen si

mundësi e vetme për mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Deri më tani mbi 62 për qind e tyre janë vaksinuar. “Do të isha shumë e kënaqur nëse arrijmë 80 për qind. Mësuesit po kthehen nga pushimet dhe jam e sigurt se do të ketë një fushatë tjetër më të madhe vaksinimi deri në shtator dhe ne do të ndihemi edhe më të sigurt në shkolla”, ka deklaruar Carovska.

Komuna e Gjilanit investon në hapësirën publike në lagjen “Iliria”

GJILAN, 17 GUSHT (ER) - Investimet e komunës së Gjilanit janë të vazhdueshme në të gjitha dimensionet, që përfshijnë infrastrukturën dhe modernizimin e saj në funksion të shfrytëzimit funksional dhe shërbimeve më të mira për qytetarët kudo që ata jetojnë.

Komuna e Gjilanit në lagjen “Iliria” ka investuar rregullimin e parkut, parkingjeve dhe hapësirës rekreative për fëmijë që ka ndryshuar pamjen e lagjes, ka krijuar qasje funksionale për banorët, hapësirë më të mirë për sektorin e biznesit dhe njëkohësisht është eliminuar

degradimi i saj. Ky projekt që është rregulluar në një hapësirë prej 3 060 metrash katrorë me 50 vende për parking të veturave për banorët dhe bizneset, me këndin e lojërave për fëmijë në sipërfaqe prej 150 metrash katrorë, ndriçimin publik dhe gjelbërimin, i ofrojnë qytetarit hapësira të

përbashkëta publike dhe lehtësojnë jetën e banorëve të kësaj lagjeje. Ky projekt ka kushtuar 84 443.63 euro dhe tashmë është vendosur një standard model i organizimit në këtë lagje, duke eliminuar kështu anarkinë e cila mbizotëronte më parë. “Bazuar në planifikimin e

komunës së Gjilanit, me standard të tillë, për kushte më të mira për banorët, do të punohet vazhdimisht, në mënyrë që shërbimi ndaj qytetarëve të jetë gjithmonë më i lartë dhe vlera e pronës private gjithnjë e më shumë të ngrehet”, ka njoftuar komuna e Gjilanit.



Komuna e Rahovecit largon dy deponi ilegale

RAHOVEC, 17 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë se mbrojtja e mjedisit mbetet një prej prioriteteve të kësaj komune. Ai ka treguar se të martën kanë pastruar dy deponi ilegale në Zoqisht dhe në rrugën për Malishevë, si dhe kanë trajtuar një rreth prej deponive legale në këtë komunë. “Edhe një herë ne u bëjmë thirrje qytetarëve që të bashkëpunojnë me institucionet për mbrojtjen e ambientit, fillimisht duke mos hedhur mbeturina në vende joadekuate, si dhe duke i raportuar tek autoritetet kompetente ata që ndotin mjedisin, duke hedhur mbeturinat në lokacione të padestinuara, të cilat më pas shndërrohen në deponi ilegale”, ka thënë Latifi. Ai ka theksuar se Rahoveci është një prej komunave më të pastra falë veprimtarive të shumëllojshme




bujqësore dhe pozitës geografike, por edhe si rezultat i angazhimit të komunës në eliminimin e deponive ilegale. “Është e drejtë e çdo qytetari që

të jetojë në hapësirë e ambient të pastër, prandaj ju ftoj që së bashku ta mbajmë të pastër Rahovecin tonë”, ka deklaruar Latifi.

Vazhdon lysterja e korridoreve të banesave kolektive në Prizren

PRIZREN, 17 GUSHT (ER) - Nën kryetari i komunës së Prizrenit, Visar Shehu, së bashku me drejtorin e Drejtorisë të Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor, Beni Kizolli, kanë vizituar të martën banesat kolektive, ku kanë përfunduar punimet e projektit të lysterjes së korridoreve. Në kuadër të këtij

projektit pritet të përmirësohen kushtet e banimit të qytetarëve, të kenë ambient më të sigurt dhe të pastër, ku deri më tani nga 50 aplikime kanë përfunduar punimet në 35 banesa. Në total pritet që mbi 600 familje të kenë një ambient më të sigurt e më të shëndetshëm për të jetuar.



Bulliqi inspekton punimet e renovimit të shkollës teknike “Fan Noli”

PODUJEVË, 17 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, i shoqëruar nga drejtori i Arsimit, Avni Fetahu, kanë vizituar të martën Shkollën e Mesme

Teknike “Fan Noli”, ku përcollën nga afër dinamikën e renovimit të objektit. Renovimi i objekteve shkollë po bëhet edhe në 13 shkolla të tjera të komunës së Podujevës, ndërsa në proces të

gëlqerosjes janë edhe 17 shkolla. “Mjediset e përmirësuara shkollë do t’u krijojnë nxënësve dhe mësuesve proces mësimor më të lehtë dhe më

cilësor”, ka thënë Bulliqi. Ai ka premtuar angazhim maksimal për përgatitjen e të gjitha objekteve shkollë për fillimin e mbarë të vitit shkollor 2021/2022.



MASHTI ndan 200 000 euro grante për financimin e qendrave burimore

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 GUSHT - "Arsimi është burim i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të Kosovës, prandaj rritja e cilësisë në arsim është synim kryesor për qeverinë", ka thënë kryeministri Albin Kurti në takim me ministrin e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci.

Ministrja e ka njoftuar kryeministrin Kurti për përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2021/2022 në arsimin e përgjithshëm parauniversitar. Në këtë takim u tha se ofrimi i mundësive të barabarta dhe gjithëpërfshirja në arsim për fëmijët nga grupet e marginalizuara vazhdon të ketë vëmendje të veçantë. Në këtë drejtim, MASHTI këtë vit ka ndarë 200 000 euro grante për financimin e qendrave burimore.

Për të mundësuar fillimin e vitit të ri shkollor me prani fizike u

theksua domosdoshmëria e vaksinimit të mësimdhënësve dhe respektimi i masave anti-Covid. Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se arsimi dhe aftësimi profesional në qeverisjen e tij ka trajtim prioritar, pasi mban çelësin e progresit teknologjik dhe industrializimit si dhe shtimit të vendeve të punës. Sipas tij, qeveria do të angazhohet për optimizimin e kualifikimeve të ofruara nga arsimi dhe aftësimi profesional, bazuar në nevojat lokale të industrisë për të plotësuar hendekun ekzistues të shkathhtësive.

Për garantimin e cilësisë në arsimin e lartë MASHTI po i financon projektet e Agjencisë së Kosovës për Akreditim që do të ndihmojnë kthimin e AKA-së në Asociacionin Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA).

Po në këtë takim u theksua se avancimi i politikave dhe kornizës ligjore në fushën e arsimit është një nga aspektet në të cilat është fokusuar qeveria.



Evakuohen dy shtetas të Kosovës nga Kabuli

PRISHTINË, 17 GUSHT (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, kanë njoftuar se dy shtetas të Kosovës, që gjendeshin në Kabul të Afganistanit, janë evakuuar nga atje dhe së shpejti do të arrijnë në Kosovë. "Për një kohë Ministria e Jashtme dhe e

Diasporës dhe zyra ime kanë punuar që të sigurojnë evakuim të sigurt të shtetasve të Kosovës nga Kabuli. Me ndihmën e Shteteve të Bashkuara dhe shteteve evropiane, dy nga qytetarët tanë janë evakuuar në mënyrë të sigurt nga vendi dhe së shpejti do të kthehen në shtëpi", ka shkruar Osmani në

rjetin social në "Twitter". Ndërsa Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) ka njoftuar se është duke vazhduar angazhimin intensiv edhe gjatë ditës së sotme për të identifikuar dhe ndihmuar shtetasit e Kosovës që ndodhen në Afganistan me qëllim të largimit sa më të shpejtë nga atje.

Mehaj e Rama, pjesë e Panairit Ndërkombëtar të Industrisë së Mbrojtjes 'IDEF 21'

STAMBOLL, 17 GUSHT (ER) - Me ftesë të ministrit të Mbrojtjes të Turqisë, Hulusi Akar, ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Armend Mehaj, po merr në ceremoninë e hapjes së Panairit të 15-të Ndërkombëtar të Industrisë së Mbrojtjes "IDEF 21" në Stamboll. Mehaj në këtë vizitë është i shoqëruar edhe nga komandanti i FSK-së, Rahman Rama.

Ministri Mehaj ka bërë me dije se, përveç takimit me ministrin Akar, së bashku me gjeneral Ramën do të takohen edhe me homologë të tjerë nga shtete të ndryshme partnere dhe shtete që janë në proces të krijimit të bashkëpunimit bilateral. "Gjithashtu gjatë katër ditëve të panairit do të takohemi me liderë përfaqësues të kompanive të

industrisë së mbrojtjes ndër më të njohurat në botë, pjesëmarrëse nga 83 shtete. Kjo është një mundësi shumë e mirë të njihemi me produktet që ndërlidhen me objektivat tona të ngritjes së aftësive dhe kapaciteteve operacionale të FSK-së në procesin tonë të tranzicionit", ka shkruar Mehaj në llogarinë e vet në "Facebook".



94 subjekte politike kanë aplikuar për zgjedhjet lokale të 17 tetorit

PRISHTINË, 17 GUSHT (ER) - Gjatë periudhës dymujore (17 qershor - 16 gusht) në Zyrën për Regjistrim të Partive

Politike dhe Certifikim kanë aplikuar 94 subjekte politike, prej të cilave 32 parti politike, 1 koalicion, 35 iniciativa qytetare

dhe 26 kandidatë të pavarur. Numri i përgjithshëm i kandidatëve që përfaqësojnë këto subjekte politike është 4

922 kandidatë, prej të cilëve 165 kandidatë për kryetarë të komunave dhe 4 757 për kuvende komunale.



Kurti: Suksesi i KEK-ut, parakusht për zhvillim ekonomik

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 GUSHT - Kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar edhe nga ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka vizituar të martën KEK-un. Ai gjatë kësaj vizite ka thënë se KEK-u përbën bërthamën e energjisë në Kosovë dhe tejkalimi i sfidave me të cilat ballafaqohet, e që gërshetojnë ato me të cilat ballafaqohemi edhe si shoqëri, do të jetë një nga përcaktuesit e suksesit të qeverisë së tij.

Kurti ka theksuar se si

ndërmarrja kryesore energjetike në vend, KEK-u, bart peshën e furnizimit me energji elektrike. "Viti i kaluar ishte vit i suksesshëm për këtë ndërmarrje të rëndësishme meqë kishte shënuar përmirësim të performancës së prodhimit të energjisë elektrike me mbi 6 000 GWh, kurse këtë vit që në gjashtëmujorin e parë është tejkaluar plani i eksploatimit të thëngjillit, me ç'rast janë nxjerrë 4.3 milionë tonë thëngjill. Furnizimi i pandërprerë dhe kualitativ i energjisë elektrike është parakusht i zhvillimit ekonomik

në vend. Për këtë duhet që të garantohet menaxhim optimal i termocentraleve dhe mihjeve, e për të siguruar këtë qeveria do t'i ofrojë mbështetje të plotë KEK-ut", ka deklaruar Kurti.

Ai ka theksuar se investimet për zvogëlimin e ndotjes së shkaktuar nga termocentralet janë të domosdoshme.

Kurti ka falënderuar Bashkimin Evropian për mbështetjen dhënë në këtë drejtim. "KEK-u duhet të jetë proaktiv e inovativ në mënyrë që të arrihet diversifikimi i prodhimit të energjisë duke inkuadruar energjinë e ripërtëritshme, në

veçanti atë solare. Këto sfida nuk duhet asesi të dekurajojnë këtë gjigant energjetik. Përkundrazi ato paraqesin potencial për transformim pozitiv të tij dhe tranzicion të drejtë energjetik për vendin, përgjatë të cilit do ta ketë përkrahjen e qeverisë", u zotua kryeministri Kurti.

Në përmbyllje të vizitës, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se KEK-ut më shumë se kurrë tani i duhet një udhëheqje profesionale e me integritet. Ajo ndau njoftimin se në muajt në vijim do të hapet konkursi publik për bordin e

rregullt të KEK-ut dhe ftoi të gjithë profesionistët e fushës të aplikojnë, me theks të veçantë gratë të cilat deri tani kanë qenë të nënpërfaqësuar. Ngjashëm, ministrja Rizvanolli inkurajoi të gjithë profesionistët e interesuar të aplikojnë edhe për pozitën e kryeshefit ekzekutiv të KEK-ut në konkursin publik i cili vazhdon të jetë i hapur deri më 23 gusht të këtij viti.

Ministrja Rizvanolli ka pohuar se qeveria është e interesuar që të sigurojë një proces fer, profesional dhe transparent të rekrutimit në pozitë e hapura në ndërmarrjet publike.



Mërgimtarët në Kosovë, në dy javët e para të gushtit erdhën 738 aeroplanë

PRISHTINË, 17 GUSHT - Në dy javët e para të muajit gusht, duke e shfrytëzuar Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari", në vendin tonë kanë aterruar 738 aeroplanë, me mbi 91 634 mërgimtarë.

Sipas Zyrës për Informim të ANP-së, brenda kësaj periudhe nga Kosova janë larguar 125 mijë udhëtarë, me gjithsej 216 758 persona. "Nga data 1 deri 15 gusht janë realizuar 738 fluturime me 125 124 udhëtarë në shkuarje, ndërsa 91 634

udhëtarë kanë ardhur në Kosovë. Gjithsej shkuarje-ardhje janë 216 758 udhëtarë", thuhet në përgjigjen e kësaj Zyre për "Telegrafi"-n.

Ndërsa gjatë tërë muajit korrik ishin realizuar 1 327 fluturime me 221 728 udhëtarë në ardhje dhe 118 477 në shkuarje. Po ashtu, mërgata vazhdon të jetë një nga burimet kryesore të financimit të shpenzimeve familjare në Kosovë. Që nga shpallja e pavarësisë, dërgesat e tyre kanë vazhduar të shënojnë

rritje.

Të dhënat e Bankës Botërore tregojnë se brenda kësaj periudhe janë dërguar 12.6 miliardë euro. Vlera më e madhe e remitencave është ajo e vitit 2020, ku pavarësisht pandemisë Covid-19, mërgata ka dërguar 1.18 miliard euro.

Nga rezultatet preliminare të regjistrimit të diasporës, numri i qytetarëve të Kosovës që jetojnë në vende të ndryshme të Evropës dhe botës, të cilët i janë përgjigjur regjistrimit, është rreth 350 mijë.



Zyrtarizimi i toskërishtes dhe përmbysja e varietetit të elbasanishtes



ALBULENA ALIDEMA

Zyrtarizimi i toskërishtes dhe përmbysja e varietetit të elbasanishtes

Standardizimi, zakonisht, bëhet së bashku me zhvillimin e një gjuhe të shkruar, ose pasi të jenë zhvilluar varietetet e ndryshme të shkruara të një gjuhe dhe teknikat e shtypura janë shpikur për të arritur një shpërndarje të gjerë të veprave letrare (Bartsch, 1987:250).

Standardet mund të evoluojnë natyrshëm, gjatë historisë, ose mund të imponohen nga iniciativat e planifikimit të gjuhës, ashtu siç u imponuan edhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe në Kongresin e Drejtshkrimit të vitit 1972.

Faktorët që kontribuojnë në shfaqjen e një standardi dhe në zbatimin e suksesshëm të një standardi janë: 1) ku shumë-llojshmëria flitet nga një grup prestigjioz, ku prestigji përcaktohet në terma të fuqisë politike ose ekonomike dhe arsimit; 2) ku shumë-llojshmëria ka një histori të shkrim-leximit, veçanërisht letërsinë e shkruar nga autorë të mëdhenj; dhe 3) ku varieteti është i vendosur në një zonë, në të cilën disa lloje të gjuhës vijnë në kontakt dhe prandaj huazohen nga njëri-tjetri dhe asimilohen (Bartsch 1987: 251). Kështu, një normë shoqërore karakteristike, e një grupi prestigjioz, rrit standardin. Në një çast në kohë, për shkak të natyrës së saj të ndryshueshme, norma ndryshon nga standardi statik dhe ndryshimet midis të dyve rriten me kalimin e kohës. Përfundimisht, hendeku bëhet shumë i gjerë, që standardi i vjetër të mbetet praktik dhe ai shembet. Një standard i ri, i sjellë nga i njëjti mekanizëm, zë vendin e tij.

Për Fernández-Ordóñez, kushtetuta e një gjuhe standarde është një proces shekullor, i cili zhvillohet në tri fronte:

a) Përzgjedhja e larmisë gjuhësore, që do të jetë baza e gjuhës standarde;

b) Përdorimi i atij varieteti të zgjedhur në të gjitha sferat e mundshme funksionale;

c) Kodimi ose rregullimi i përdorimeve gjuhësore të asaj larmie (sipas Fernández-Ordóñez 2005: 231).

Pra, siç na e mëson përvoja historike e zhvillimit njerëzor, gjuha është një mjet shumë i rëndësishëm i komunikimit, i marrëdhënieve ndërmjet njerëzve.

Ajo, si fenomen shoqëror, është e lidhur, në mënyrë të pazgjidhshme, me historinë e shoqërisë, pra është e lidhur drejtpërdrejt me çdo veprimtari të njeriut.

Mirëpo, duhet pranuar faktin që në gjuhën tonë kontributi i studiuesve të gjuhës është përcaktuar nga rrethanat dhe kushtet konkrete historike-shoqërore, e veçmas ato politike në të cilat është formuar dhe zhvilluar gjuha jonë letrare që sot njihet si gjuha standarde shqipe. Historikisht, një rol përcaktues, për hartimin e gjuhës standarde, ka luajtur edhe forca udhëheqëse e asaj kohe, e organizuar në partinë e vetme politike, e quajtur Partia e Punës së Shqipërisë, që ka pasur një mbizotërim absolut në të gjitha sferat e organizimit politik dhe shoqëror në Shqipëri, duke përfshirë këtu edhe jetën shkencore, arsimore e kulturore, për më shumë se gjysmë shekulli.

Për t'i argumentuar rrethanat e mbizotërimit dhe ndikimit politik e ideologjik, për përcaktimin e standardit gjuhësor të shqipes, duhet rikthyer te tradita e shkrimit të gjuhës shqipe. Në këtë mënyrë, çështjen e traditës së shkrimit të shqipes duhet parë në vijimësinë e mëhershme, duke filluar me veprën e Buzukut, Budit, Bardhit e Bogdanit, gjuha e të cilëve ishte një gegërishte e përgjithshme.

Varianti letrar i gegërishtes, që nisi me Buzukun dhe Mesharin e tij, si librin e parë shqip (1555), evoluoi për shekuj me radhë e deri më 1939, duke ndjekur rregullat e ligjësitë e veta të brendshme dhe duke i përmbushur funksionet e veta brenda koinesë së gegërishtes. Ky variant ishte përpunuar, thuhet, i tëri nga elita shqiptare katolike dhe ishte përdorur për t'u shërbyer qëllimeve të këtyre elitave, të cilat koïncidonin me interesat kombëtare të mbarë shqiptarëve (Vehbiu 2007:27).

Tutje, studiuesi, Ardian Vehbiu konstaton se: kur komunistët morën pushtetin dhe filluan të vënë në zbatim planet e tyre afatgjata, për një Shqipëri monolite, varianti letrar gegë e humbi menjëherë energjinë e vet të mëparshme. Figurat madhore të elitës katolike gege, si Fishta e Koliqi, u sulmuan menjëherë si 'reaksionarë' dhe 'armiç të popullit', çka bëri që edhe veprat e tyre të hiqeshin nga qarkullimi dhe, në ndonjë rast, edhe të asgjësoheshin materialisht (Vehbiu 2007:28).

Kështu që, pas Luftës së Dytë Botërore regjimi i ri në Republikën e Shqipërisë, pa ndonjë debat paraprak, hodhi poshtë gjithë punën e mëparshme rreth standardizimit të shqipes dhe vendosi toskërishten bazë të gjuhës standarde shqipe. Fatkeqësisht, bëri gabimin e njëjtë, në mos edhe më të rëndë, ngaqë me këtë

vendim jo vetëm që nuk integroi veçorinë gjuhësore, më të rëndësishme të gegërishtes, në këtë standard toskë, dmth. paskajoren e mirëfilltë por, në një proces shkallë-shkallë, ndaloi krejtësisht edhe përdorimin e gegërishtes letrare në emër të njësimi kombëtar.

Gjatë kësaj kohe gegërishtja letrare humbi statusin, duke rënë nga një varietet i lartë gjuhësor në një varietet të ulët. Ky është një fakt i njohur, që përdorimi letrar i gegërishtes filloi të bjerret në mënyrë të vazhdueshme.

Pra, gjuha shqipe në historinë e zhvillimit të saj ka përjetuar dy standardizime zyrtare. Fillimisht, më 1920, në Kongresin Arsimor të Lushnjës, ishte vendosur që e folmja e Elbasanit, e folme e gegërishtes veriore, të ishte gjuhë zyrtare shqipe, ndërsa më 1972 u mbajt Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, me ç'rast në bazën e standardit të shqipes u vu përfundimisht toskërishtja.

Është viti 1916, një vit me rëndësi themelore, në të cilin u diskutua çështja e formimit të gjuhës së përbashkët. Pas debateve të shumta, u vendos dhe u miratua, njëzëri, teza e Luigj Gurakuqit, për zgjedhjen e dialektit të elbasanishtes si gjuhë shkrimi.

Me këtë rast, Gurakuqi propozoi këtë formulë:

"Tue qenë, se djalekti i Elbasanit edhe ndën pikëpamjen e formavet, por sidomos ndën pikëpamjen e sintaksës është si një urë në mes të toskërishtes e të gegërishtes, duhet të zgjidhet si gjuhë shkrimi me ato rregulla ortografike, qi të na duken të drejta e t'arsyeshme. Po tue dhënë këtë vendim Komisia Letrare duhet të mbajë gjithmonë para sysh detyrën, qi të bähën kërkimet e nevojshme, qi të gjinden format e mesme, të cilat afrojnë ndryshimet djalektologjike të dy djalekteve". ("Lajmet e Komisionit Letrare Shqipe": 1981:11).

Sipas studiuesit Mehmet Çeliku, zgjedhja e dialektit të Elbasanit, si gjuhë shkrimi dhe vendosja e tij në themel të ortografisë së gjuhës zyrtare e të përbashkët, plotësonte, realisht, këto kushte themelore:

Elbasanishtja ishte një e folme gege me tipare të përbashkëta të afërta si me gegërishten veriore, ashtu edhe me toskërishten. Siç thoshin, Gurakuqi e Xhuvani, ajo ishte një urë mes toskërishtes e gegërishtes;

Elbasanishtja ishte një e folme gege me tradita shkrimore pa largime të theksuara dialektore, traditë kjo që përkonte në shumë pika, më tepër me toskërishten letrare sesa me gegërishten letrare veriore;

3. Elbasanishtja, si nënvariant i një qendre të rëndësishme ekonomike e kulturore, ofronte traditën shkrimore të figurave të shquara, që spikatnin si në studimin e shqipes, ashtu edhe në

përdorimin praktik të saj, në kate të kësaj tradite udhëhiqte babai i gjuhës shqipe Konstandin Kristoforidhi (Çeliku 2001: 76).

Pra, siç rezultoi nga argumentet e mësipërme, bazat e standardizimit të shqipes ishin hedhur nga Komisia Letrare e Shkodrës qysh më 1916.

Në kuptim të përbërjes, funksionit dhe qëllimit, mund të thuhet se Komisia Letrare e Shkodrës është e para akademi e shkencave dhe e artit, me përfaqësues të spikatur të trurit e artit shqiptar. Meqë standardi i Komisionit kishte për bazë të folmen e Elbasanit, për shumë studiues kjo e folur ishte përhapur jo si mur ndarës, por si një urë lidhëse për dy dialektet kryesore (Elezi 2010: 85).

Vendimet e marra në Komisionin Letrare, për njësimin e drejtshkrimit të gjuhës letrare kombëtare shqipe, patën jehonë në të gjithë Shqipërinë. Përveç kësaj, ato u miratuan edhe nga Kongresi Arsimor i Lushnjës më 1920.

Mirëpo, pavarësisht prej faktit se ky varietet i afroonte edhe më shumë të dy dialektet e shqipes, shumë vite më vonë, në Kongresin e Drejtshkrimit, arritjet e tij u shembën me urdhër politik, pra, edhe më keq, mohohet edhe vetë qenia e tij. Pra, ky standard pati një përmbysje për t'u vendosur në vend të tij një normë gjuhësore, që kishte më tepër tipare të toskërishtes, sidomos sa i përket sistemit fonetik.

Pas vitit 1972, kur Kongresi i Drejtshkrimit i Gjuhës Shqipe sanksionoi përdorimin e një standardi të shqipes, mbështetur, në masë të madhe në dialektin toskë, gegërishtja nuk u lejua të përdoret si mjet komunikimi kulturor.

Pra, disa vjet më vonë, pas humbjes së prestigjit të gegërishtes letrare, filloi të përdorej një standard tjetër, i cili filloi të mbrohej nga shumë autorë. Kontributin e këtyre autorëve, në lëvimin dhe njësimin e standardit të ri, e përmend edhe studiuesi Çeliku, i cili, mes të tjerash, shprehet: *Gjuhëtarët shqiptarë, më shumë se një shekull, kanë punuar për lëvimin, njësimin e kodifikimin e sistemit drejtshkrimor e gramatikor të shqipes letrare. Për lëvimin e njësimin e toskërishtes letrare e për ngritjen e këtij varianti në standard, kanë punuar gjuhëtarët e mirënjohur, K. Kristoforidhi, S. Frashëri, S. Shuteriqi, E. Çabej, K. Cipo, M. Domi, A. Kostallari, I. Ajeti, Sh. Demiraj e shumë gjuhëtarë të tjerë* (Çeliku 2002: 167).

Pra, shumë autorë punuan në lëvimin e toskërishtes por, duke e injoruar varietetin e gegërishtes, në këtë mënyrë gegërishtja e humbi edhe prestigjin e saj. Pra, duke lëvruar një varietet dhe duke anashkaluar dhe injoruar varietetin tjetër, krijohen predispozitat për

mbizotërimin e varietetit më të lëvruar dhe më të privilegjuar, siç ka ndodhur edhe me toskërishten. Ky raport i varieteteve gjuhësore është analizuar edhe nga studiues të ndryshëm, të huaj, që kanë dhënë teori dhe interpretime, sipas këndvështrimeve të tyre. Kështu, sipas Kramshit (2008), *kjo është edhe mënyra se si identiteti kulturor shprehet nëpërmjet një gjuhe standarde, të krijuar artificialisht, pra, nëpërmjet lirimit nga shumësia e dialekteve. Kur njëri variant gjuhe zgjidhet si një indikator i diferencës, midis të brendshmeve dhe të jashtmeve, ai variant mbrohet nëpërmjet gramatikave dhe fjalorëve zyrtarë e që mund të futet edhe në sistemin e edukimit nacional* (Kramshi 2008:448).

Ndërsa Haugen thotë se të zgjedhësh një variant si normë, do të thotë të favorizosh një grup njerëzish, të cilët e flasin këtë variant të gjuhës. *Kjo u jep atyre prestigjin si mbartës të normës dhe një përparësi në garën për pushtetet dhe pozitën* (vep. e cituar sipas Byron 1996:18).

Ndërsa për A. Millet: *Gjuha nuk mund të trajtohet si një produkt industrial, megjithatë, thotë ai, - të folmet lokale vdesin ashtu siç zhduken artizanatet e vegjël, përpara industrialistëve të mëdhenj, që prodhojnë me seri të mëdha* (Cituar sipas Mansaku 2002:109).

Praktikisht, një gjë e tillë ndodhi edhe në standardin e gjuhës shqipe. Edhe pse kishim një standard paraprak, ai u përmbys në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe dhe u ndërta një standard tjetër, i cili mbrohej nga hartuesit e gramatikave dhe fjalorëve të asaj kohe. Pra, një rol me rëndësi, për përmbysjen e këtij varieteti, luajti edhe Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, që ishte një paraprijëse e Kongresit të Drejtshkrimit.

Duke e ditur që në Kosovë gjendja ishte krejtësisht ndryshe, gjuhëtarët e Kosovës kishin probleme për gjuhë, përderisa në Shqipëri problemi kryesor ishte në gjuhë, pra cila do të ishte baza e gjuhës standarde. Në këtë kontekst, studiuesi Mehreshaj shprehet: *Në trojet shqiptare të Federatës, gjendja ishte krejt e ndryshme. Atje, një pjesë të funksioneve nacionaliste i kryente gegërishtja, me statusin gjuhë rajonale. Mirëpo, intelektualët kosovarë e kishin nuhatur rrezikun, që kjo diglosi, në rrafshin nacionalist, të shfrytëzohej prej qarqeve shovene serbe për të përjetësuar studimin e tyre në Kosovë, duke e thelluar e përjetësuar këtë ndarje të shqiptarëve edhe me emrin 'shiptarski jezik' për idiomën e këtushme dhe 'albanski jezik' për idiomën e Shqipërisë së Poshtme.*

(Vijon)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Dukagjini, jo për aventurë në Superligë, paraqet dyshen Shabani - Haxhihamza

KF Dukagjini pritet të jetë skuadër stabile në elitën e futbollit të Kosovës. Për të arritur sukses në kampionatin 2020/2021, Dukagjini ka transferuar 13 futbollistë cilësorë. Të hënën ka paraqitur mesfushorin Bujar Shabani dhe portierin Kenan Haxhihamza

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 GUSHT - Skuadra e Dukagjinit nga Klina ka realizuar 13 transferime në këtë afat kalimtar, por dyshen Bujar Shabani-Kenan Haxhihamza e ka paraqitur të hënën. Klubi nga Klina, që u rikthye në Superligën e Kosovës në futboll, ka qenë mjaft aktiv gjatë gjithë afatit kalimtar, derisa në edicionin ri pritet të jetë "arrë" e fortë për skuadrat kundërshtarë.

Futbollisti nga Ferizaj, Bujar Shabani, edicionin e kaluar ishte pjesë e skuadrës së Dritës nga Gjlani, derisa në përfundim të kampionatit 2020/21 u largua dhe iu bashkua skuadrës së Shkupit me të cilën mori pjesë në garat ndërkombëtare.

"Mesfushori defansiv ka një karrierë të pasur në futbollin shqiptar, pasi më parë ka luajtur edhe në klubin e Ferizajt dhe të Feronikelit, ndërkohë në Shqipëri ishte aktivizuar te klubi i Skënderbeut nga Korça. Shabani sezonin e kaluar ishte paraqitur në 34 ndeshje të Superligës, dy në Kupën e Kosovës dhe dy paraqitje i kishte në kualifikimet



e Ligës së Evropës", thuhet në njoftimin e Dukagjinit.

Të hënën klubi nga rrafshi i Dukagjinit e prezantoi edhe portierin Kenan Haxhihamza. Ky i fundit ka një karrierë mjaft të pasur në elitën e futbollit të Kosovës. Në edicionin e fundit Haxhihamza ishte pjesë e Ballkanit, kurse më herët e ka

djersitur edhe fanellën e Gjilanit. "Kenan Haxhihamza i bashkohet Dukagjinit. Portieri rahovecian i bashkohet Klubit të Dukagjinit nga skuadra e Ballkanit. Haxhihamza, i lindur më 28 dhjetor 1996, i ka mbrojtur edhe ngjyrat e Gjilanit për katër sezone me radhë. 24-vjeçari tash e tutje do të jetë pjesë e klubit

tonë, të cilit i urojmë mirëseardhje dhe suksese në fanellën bardhegjelbër", thuhet në njoftimin e skuadrës nga Klina.

Portieri nga Rahoveci e ka falënderuar skuadrën e Dukagjinit për besimin e dhënë dhe është i bindur se do të ketë sukses me këtë klub. "Faleminderit për besimin për të qenë pjesë e KF Dukagjini. Puna dhe përkushtimi maksimal do të jenë bashkudhëtarë të mi në këtë rrugëtim që shpresoj në fund të shpërblehet me sukses. Mirë se të gjeta, Klinë!", ka thënë Haxhihamza.

Skuadra e Dukagjinit në afatin kalimtar të verës ka transferuar këta futbollistë: Amer Duka, Arbër Shala, Argjend Bardhi, Henry Chibueze, Ergyn Ahmeti, Moriba Lamah, Ardin Dallku, Ermal Vitija, Ahmed Januzi, Jozef Kuqi dhe Jean Carioca.

Trajnerët kërkojnë nga FFK-ja më shumë lojtarë në bankën rezervë

PRISHTINË, 17 GUSHT - Superliga e Kosovës kthehet në aksion në fundjavë, ndërsa rregulli për pesë zëvendësime do të vlejë edhe këtë sezon. Por trajnerët për një ndeshje kanë të drejtë të regjistrojnë në protokoll vetëm 18 futbollistë. Trajnerët e Superligës, Bekim Isufi, Ardian Nuhiu dhe Armend Dallku, për "Gazeta Olle" kanë shprehur mendimin që numri i lojtarëve në bankë duhet të rritet.

Bekim Isufi, i cili do ta drejtojë Ballkanin këtë sezon, ka thënë që kjo është shumë e nevojshme. "Patjetër që duhet të aplikohet numër më i madh i lojtarëve në bankë, duke e ditur se kemi 5 zëvendësime dhe kjo është e nevojshme. Duhet medoemos të zgjerohet numri i lojtarëve në bankën rezervë", ka thënë Isufi.

Edhe trajneri i Dritës, Ardian Nuhiu, shpreh mendim të njëjtë. Ai ka thënë që me shtimin e numrit të lojtarëve shumë lojtarë do të ishin më afër skuadrës.



"Mendoj se duhet të rritet numri i lojtarëve në protokoll. Në momentin që i ke të gjithë futbollistët në stol, ke më tepër mundësi ndryshimi, sepse asnjëherë nuk e di se loja çfarë kahu mund të marrë", ka deklaruar Nuhiu. "Kjo do të ishte mirë edhe të mos ndash lojtarët nga grupi por, thjesht, ta ndiejë çdo moment të lojës afër bashkëlojtarëve apo edhe të presin mundësinë për ta ndihmuar ekipin. Çdo futbollist është pjesë e rëndësishme e skuadrës", ka shtuar Nuhiu.

Se numri i lojtarëve në bankë duhet të rritet nga 18 në 21, apo 22, ka thënë edhe trajneri dhe ish-futbollisti i njohur Armend Dallku. "Unë jam për rritjen e numrit të futbollistëve në bankën rezervë, pasi që kemi drejt t'i bëjmë 5 zëvendësime. Pse të mos na jepet mundësia të kemi numër më të madh në bankën rezervë", ka thënë Dallku. Me shtimin e numrit të lojtarëve në bankën rezervë, do t'u jepet mundësi më e madhe talentëve që të jenë afër ekipit, pse jo që në pjesën e dytë edhe të inkuadrohen në lojë.

Marku më 25 shtator lufton për titullin 'IBF International'

LONDËR, 17 GUSHT - Boksieri shqiptar Florian Marku ka zyrtarizuar datën e duelit të radhës dhe kjo pritet të jetë mjaft e rëndësishme për një hap të madh në karrierën e Markut. Më 25 shtator Florian Marku do të ndeshet me boksierin ukrainas Maksim Prodan për titullin IBF në stadiumin e Tottenham Hotspurit në Londër. Dueli do të zhvillohet në prani të 78 000 tifozëve teksa sfida kryesore e mbrëmjes do të jetë ajo midis kampionit të botës në peshat e rënda Antony Joshua kundër Oleksandr Usyk. Lajmin e bëri me dije vetë Florian Marku me anë të një postimi në "Facebook". "Përshëndetje të gjithë shqiptarë kudo që jeni. Kemi lajme të mira. Ndeshja e radhës kundër Maxim Prodan për titullin IBF International do të zhvillohet më 25 shtator në



stadiumin Tottenham Hotspur. Do të jenë të pranishëm 78 000 mijë spektatorë. Në mbrëmje ndeshet Anthony Joshua me Alexander Usyk. Ju pres të gjithëve atje dhe, gjithashtu, siguroni biletat tani online para se të jetë vonë", ka shkruar Marku.

Messi pritet të debutojë më 29 gusht

Paris, 17 gusht - Pasi u bë një ndër transferimet më të bujshme të PSG-së, e gjithë vëmendja e fansave tanimë është vendosur në ditën kur do të debutojë Lionel Messi me fanellën e parisienëve. Në sfidën kundër Strasburgut këtë javë,

Messi u paraqit para tifozëve në "Park Des Princes", ndërsa enigmë mbetet data e debutimit. Sipas "Sky Sports", Messi nuk do të debutojë as këtë javë në sfidën për kampionat kundër Brestit, por me shumë mundësi do të jetë në

fushë të dielën e ardhshme, më 29 gusht, në javën e 4-të të kampionatit kundër Reimsit. Një debutim i cili po pritet me interes nga e gjithë bota për të parë një ndër lojtarët më të mirë të historisë në fushë përsëri.



Ancelotti: Nuk e kam kërkuar Ronaldon

MADRID, 17 GUSHT - "Ancelotti kërkon Cristiano Ronaldon te Real Madridi", ky ishte lajmi i sotëm i Chiringuito, ndërkohë që ka reaguar trajneri i skuadrës spanjolle. Italiani ka hedhur poshtë gjithçka me deklaratën e

dhënë. "Cristiano Ronaldo është një legjendë e Real Madridit dhe me të vërtetë e respektoj atë. Gjithsesi unë nuk kurrë nuk kam kërkuar apo planifikuar të nënshkruaj me Cristianon këtë verë. Po shohim përpara..."

është shprehur Ancelotti. Edu Aguirre, një mik i vjetër i CR7, kishte deklaruar më parë: "Po flasim për të ardhmen e afërt dhe jo për qershorin e vitit 2022. Ekziston mundësia që gjithçka të ndodhë para 1 shtatorit. Ka

komunikime të vazhdueshme dhe mund të arrihet një marrëveshje. Carlo Ancelotti dëshiron ta rikthejë Cristiano Ronaldon te Real Madridi dhe është e gjitha e vërtetë. Ai këmbëngul në një rikthim të



bujshëm të CR7. Marrëdhënia mes të dyve është shumë e mirë".

Përfundon afati kalimtar në basketboll

PRISHTINË, 17 GUSHT - Ka përfunduar afati kalimtar në basketboll në konkurrencën e meshkujve. Afati kalimtar ishte shumë i pasur, ku kishte transferime nga skuadrat e mëdha, kurse më pak aktive ka qenë Drita, që nga Liga e Parë do të garojë në elitën e basketbollit. Të gjitha skuadrat e tjera të elitës kanë bërë transferime dhe pritet një stinor mjaft interesant. Po ashtu, edhe klubet e Ligës së Parë dhe të Dytë kanë qenë aktive, varësisht që kanë në edicionin e ri. Afati kalimtar ka përfunduar për basketbollistë vendorë, derisa vazhdon ai për të huaj.



Mirlind Zekaj, Erdem Ilter, Henrik Sirko, Daniel Lekndrejaj

Henry, Fells Courtney Shamon, Nick Weatherspoon

SIGAL PRISHTINA

Jan Palokaj, Lejson Zeqiri, Wendell Mitchel, Nicholas Tomsick, Jon Ismajli, Arbër Berisha

BASHKIMI

Valon Bunjaku, Andi Shehu, Edmond Kryeziu, Artin Gashi

PEJA

Arian Qallaku, Sami Hajzeri,

TREPÇA

Amin Hot, Taurus Ramon Cockfield, Gerald Blackshear, Andrew Michael Gordon, Samir Zekiqi

GOLDEN EAGLE YLLI

Arlind Pepaj, Mikaile Tmusiq, Leon Neziri

RAHOVECI

Fisnik Rugova, Arion Balluka, Mërgim Jakupi, Musab Mala, Ergin Grosha, Thomas Myles, Davis Eric JR Tyree, Wesley Marc Alcegaire

PRIZRENI-16

Rilind Krasniqi, Walker TyranJamall, Johnson Isaiah

Alonso: Nëse do të dueloja me Fernandon e 15 vjetëve më parë, do të fitoja me një dorë

MADRID, 17 GUSHT - Piloti spanjoll Fernando Alonso u rikthye këtë sezon në Formula 1 pas dy vjetësh pushim. Dy herë kampioni i botës garon me skuadrën franceze Alpine, ku synon më shumë se një "paraqitje dinjitoze në pistë". Spanjollit shprehet se tash ndihet shumë më i fortë se dikur, 15 vjet më parë, kur shpallej kampion bote me Renault. Madje Alonso shprehet se nëse ai do të përballej në pistë me Fernando e 15 vjetëve më parë, do ta mposhte edhe nëse do të pilotonte vetëm me një dorë. "Ky nuk është një sport si të tjerët, si Turi i Francës në çiklizëm, futbollit, tenisi etj., kur në



moshën 23-vjeçare je në kulmin e karrierës. Nëse unë sot do të përballesha me veten time, me Alonso që garonte e fitonte 15 vjet më parë, do ta mundja me një dorë të vetme", u shpreh Fernando Alonso. "Mendoj se kjo

gjë nuk vlen vetëm për mua, por për të gjithë pilotët nëse bëjnë një krahasim. Në Formula 1 nuk ka të bëjë moshë me të qenit më i shpejtë në pistë. Në këtë sport kronometri i moshës nuk ka shumë vlerë", ka shtuar Alonso.

SHKURT

Pacquiao: Kjo mund të jetë sfida ime e fundit në ring

Sfida e 21 gushtit ndaj kubanezit Yordenis Ugas mund të jetë e fundit në karrierën legjendare të boksierit filipinas Manny Pacquiao. Lajmin e konfirmoi vetë boksieri 42-vjeçar i cili ka thënë se kjo mund të jetë hera e fundit që ai ngjitet në ring.

Pacquiao ka një rekord prej 62 fitoresh, 7 humbjesh e 2 barazimesh në karrierën e tij 25-vjeçare, duke qenë një nga legjendat e këtij sporti, kampioni i shumëfishtë i botës. Filipinasi nuk duelon që prej korrikut 2019, mungesë kjo e kushtëzuar edhe nga pandemia. "Jam duke bërë më të mirën në stërvitje, duke shkuar përtej limiteve, ndaj jam gati për sfidën e radhës. Asnjëherë nuk e kam nënvlerësuar kundërshtarin, pasi edhe ai grushton ashtu si unë. Shpresoj që këtë sfidë ta ndjekin sa më shumë, pasi mund të jetë e fundit për mua. Nuk e kam vendosur ende, këtë gjë e di vetëm Zoti, ndaj ju falënderoj për mbështetjen", ka thënë Pacquiao.

Mbappe refuzon çdo ofertë për të vazhduar kontratën me PSG-në

Kylian Mbappe i ka propozuar haptazi Nasser Al-Khelaifi se ai dëshiron të largohet nga PSG-ja dhe të negociojë me Real Madridin. Ai e ka parashtruar këtë pa kërkesa ose kërcënime, por me vullnet të vendosur. Sipas "Gazzetta dello Sport", Kylian Mbapp pritej të shpallte të ardhmen e tij publikisht. Ky plan është në dyshim, pasi mund të kuptohet si një kërcënim për PSG-në. Mbappe synon të luajë edhe këtë sezon në kryeqytetin francez dhe pastaj të transferohet si lojtar i lirë ku të dojë verën e ardhshme. Në fund të vitit 2019 Mbappe tashmë kërkoi më shumë përgjegjësi në ekip në mënyrë publike, por PSG-ja ofroi një të tjerë. Sidomos me mbërritjen e Messit, që tani shfaqet si ylli kryesor i klubit, pa harruar Neymarin, talenti francez del në plan të dytë.

Abraham transferohet te Roma

Roma ka njoftuar zyrtarisht transferimin e Tammy Abraham nga Chelsea. "Giallorossët" kanë zëvendësuar Edin Dzekon, i cili u transferua në Inter, me 23-vjeçarin anglez i cili nënshkroi një marrëveshje deri në qershor 2026. Roma do të paguajë 40 milionë euro duke përfshirë bonuset dhe një përqindje nëse shitet në të ardhmen. Abrahami është larguar nga Chelsea pas 82 ndeshjeve zyrtare, duke kontribuar me 30 gola dhe 12 asistime.

Juve përforcohet me Locatellin

Manuel Locatellit më në fund i është plotësuar dëshira që të bashkohet me Juventusin. Pas shumë bisedimesh Juventusit dhe Sassuolo kanë rënë dakord për çmimin e tij. Sipas gazetarit Fabrizio Romano, marrëveshja mes dy klubeve është arritur për shumën e rreth 35 milionë eurove, plus bonuset. Ndërsa futbollisti do të nënshkruajë kontratë pesëvjeçare të vlefshme deri në qershor të vitit 2026. Zyrtarizimi i mesfushorit si futbollist i "Zonjës së Vjetër" do të bëhet gjatë ditëve në vijim.

Nainggolan: Në Belgjikë erdha për relaksim, jo për para

Radja Nainggolan është larguar nga futbollit italian pas 17 vjetëve qëndrim. Mesfushori belg ishte transferuar te të rinjtë e Piacenzas në vitin 2004 nga Berschot U19. Që nga ajo kohë Nainggolan ka luajtur vetëm për

Serinë A me skuadra si Piacenza, Cagliari, Roma dhe Interi. Por në moshën 33-vjeçare, Ninja ka vendosur të rikthehet në Belgjikë, ku ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me Royal Antwerpen. Ninja u kërkua me

ngulm nga Besiktas, por ai vendosi për t'u rikthyer në Belgjikë dhe nuk desh të luante për para. "Po të kisha bërë një zgjedhje për para, do të kisha shkuar në Turqi. Por në moshën 33-vjeçare, pasi kam luajtur në klube të mëdha,

nuk kisha luajtur asnjëherë në Belgjikë. Është një motivim më shumë edhe që të më njohin këtu. Në Itali stresi po bëhej shumë i madh. Këtu ka ambicie, por edhe më shumë relaksim", ka deklaruar Nainggolan.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade
 Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
 Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)
 Agjencia za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu (KIESA)

Me qëllim të promovimit të kompanive prodhuese të Kosovës në gjatë të tregjeve të huaja për eksport, Ministri e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë

Thirrje publike për aplikim për pjesëmarrje të shtetasve të Kosovës në panair të produkteve ushqimore dhe pijve Anuga 2021 të FÖLN COLOGNE të Gjermanisë më 09-13 tetor 2021

Parqizimi shtetëror organizohet nga Ministri e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MTI), përkatësisht Agjencia për investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), e cila mbulon shpërzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e shtandit, regjistrimin dhe dhjetë (10) subjektve pjesëmarrëse shpërzimet e energjisë elektrike, pastriqindor et. ndërsa shpërzimet e udhëtimet akomodimit ushqimor, dërcimor e materialëve prodhues et. të shtesë pjesëmarrëse do të marrin pjesë për gjatë të shtetasve të Kosovës.

Ju lutem vini re se vetëm shprehjet e interesimit të dërguara der më datë 27.08.2021 dhe vetëm aplikacionet plotësuar ërësiht mund të konsiderohen për vlerësim.

- Për të përkrahur duet dorëzuar
 - Aplikacionin plotësuar më të dhënat e kësaj subjektve aplikues dhe
 - Dokumentet kërkuara
- Dokumentet e domosdoshme për aplikim:
 - Dëshmi në që subjektve aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës
 - Dëshmi në të dhëna të aktive në nënërinë për bankave të llogaritë nga Banka Qendrore e Kosovës
 - Kopja e lernjftit të personit autoruar të subjektve aplikues
 - Vërtetimin nga Gjykatë që dëshmon që personi autoruar i subjektve nuk është nën hetim kërkohet origjinali, jo më i vjetër se 30 ditë.
 - Deklaratën në btm;
 - Vërtetimin e qarkullimit të subjektve aplikues për vitin fiskal 2020 nga Administrata e Tmoresë e Kosovës; dhe
 - Vërtetimin të autorit të subjektve aplikues për obligimet e kryera ndaj Administratës së Tmoresë të Kosovës, më së vjetër egjastë (6 muaj)

Ju lutem vini re se në mungesë të cilido dokument të kërkuar në listën më sipërme aplikacioni i subjektve aplikues do të diskualifikohet dhe nuk do të shqyrtohet në mënyrë të veçantë të listuar më poshtë

- Dhjetë (10) subjektve pjesëmarrëse do të përzgjedhen sipas kriterit të veçantë të vijim dhe angjimit të mëposhtme:
 - Produktet që subjektve aplikues do të ju ofrojnë blloqetve potencialë panair maksimum dhjetë (10) pikë: një (1) pikë për një (1) produkt të tre (3) pikë për dy produkte të pesë (5) pikë për tri (3) produkte të shtatë (7) pikë për katër (4) produkte dhe dhjetë (10) pikë për pesë (5) e më shumë produkte;
 - Njohuria e gjatë të huaja dhe afërsisht të përcaktuara të subjektve aplikues, maksimum dhjetë (10) pikë kumulativë: gjatë anglisë pesë (5) pikë, gjatë gjermanisë katër (4) pikë dhe gjatë turqisë një (1) pikë;
 - Materiali i promovues të subjektve aplikues në gjatë të huaja maksimum dhjetë (10) pikë kumulativë: në gjatë anglisë katër (4) pikë, në gjatë gjermanisë katër (4) pikë dhe në gjatë turqisë dy (2) pikë;
 - Shtetëtarë të jashtëm të produktet të subjektve aplikues gjatë viteve 2019 dhe 2020, maksimum dhjetë (10) pikë kumulativë: shtetëtarë të BE-së pesë (5) pikë shtetëtarë të Ballkanit Perëndimor që nuk janë anëtarë të BE-së (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut) pikë dhe të tjerët të tjerë dy (2) pikë;
 - Certifikimi i komertit të subjektve aplikues, maksimum pesë (5) pikë kumulativë: HACCP dy (2) pikë, ISO 22000 dy (2) pikë dhe certifikime të tjerë relevante një (1) pikë;
 - Parqizimi i subjektve aplikues në panair të tri (3) viteve fundit maksimum pesë (5) pikë: një panair një (1) pikë, dy panair dy (2) pikë, tri panair tri (3) pikë, katër panair katër (4) pikë dhe pesë panair pesë (5) pikë dhe më shumë panair rreth pesë (5) pikë dhe;
 - Qarkullimi i vjetër i subjektve aplikues gjatë vitit fiskal 2020, maksimumi dhjetë (10) pikë nga zero deri në 500.000 euro katër (4) pikë nga 500.001 deri në 1.000.000 euro të katër (4) pikë nga 1000.000 euro deri në 1000.000 euro katër (4) pikë;

Më 16.08.2021, në ora 14:00 në sallën e takimeve të KIESA-s, zyrtarët e KIESA-s do të përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe përmbledhimet e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair të subjektve të kanë nevojë për asistencë për plotësimin e kësaj formulari, shkëlqimor të hashtutë marrin pjesë këtu kam

Subjektet që shprehin interesim në pjesëmarrje në panair duhet të aplikojnë në afatet e mëposhtme dhe të marrin pjesë në panairin më 09-13 tetor 2021 në zyrën e Arkivit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rr. "Arbënore Astrit Dehari" nr.21 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në momentin e aplikimit subjektve aplikues të gjatë hapësirë gjatë të obligimet, kriteret dhe detajet e panairit mund të gjeni në fuqinë e kësaj dhe të veçantë të panairit në kësaj publike.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade
 Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
 Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)
 Agjencia za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu (KIESA)

U cilju promovisanja proizvođačkih kompanija na Kosovu u pronalazenju stranih tržišta za izvoz, Ministarstvo Trgovine i Industrije preko Agencije za Investicije i Podršku Preduzećima na Kosovu (KIESA) objavljuje:

Javni poziv za apliciranje za učešće na državnom štandu Kosova na sajmu prehrambenih proizvoda "ANUGA 2019" Cologne u Nemačkoj 09 - 13 october 2021

Državna prezentacija se organizuje od strane Ministarstva Trgovine i Industrije, odnosno Kosovske Agencije za Investicije i Podršku Preduzećima KIESA koja pokriva troškove izložbenog prostora, izgradnju štanda, registraciju deset (10) učesnika, troškove električne energije, svakodnevno čišćenje, itd., dok će troškovi putovanja, smeštaja, hrane, isporuke promotivnog materijala itd. subjekata koji učestvuju, biti preduzeti od samih učesnika.

Molimo obratite pažnju da se samo izražena interesovanja posla do 27.08.2021 i samo u potpunosti popunjene aplikacije se mogu uzeti u obzir za ocenjivanje.

- Da biste aplicirali treba dostaviti:
 - Aplikaciju popunjenu osnovnim podacima subjekta koji aplicira; i
 - Potrebne dokumente.
- Potrebni dokumenti za apliciranje:
 - Dokaz da je aplikant registrovan u Republici Kosovo;
 - Dokaz o aktivnom računu u jednoj od banaka licencirana od strane Centralne Banke Kosova;
 - Kopija lične karte ovlašćenog lica aplikanta;
 - Uverenje Suda da ovlašćeno lice subjekta nije pod istragom (potreban je original, ne stariji od 30 dana);
 - Izjava pod zakletvom;
 - Potvrda godišnjeg prometa aplikanta za fiskalnu godinu 2020 od strane Poreske Administracije Kosova; i
 - Poresko uverenje aplikanta o izvršenim obavezama prema Poreskoj Administraciji Kosova, ne stariji od šest (6) meseci.

Molimo obratite pažnju da u nedostatku bilo kog dokumenta koji se zahteva na gore navedenoj listi, aplikacija aplikanta će biti diskvalifikovana i neće se dalje razmatrati za specifične kriterijume navedene u nastavku.

- Deset (10) učesnika bit će odabrani prema sledećim specifičnim kriterijumima i tačkama rangiranja:
 - Proizvode koje će aplikant pružiti potencijalnim kupcima na sajmu, maksimalno deset (10) poena: jedan (1) poen za jedan (1) proizvod, tri (3) poena za dva proizvoda, pet (5) poena za tri (3) proizvoda, sedam (7) poena za četiri (4) proizvoda i deset (10) poena za pet (5) ili više proizvoda;
 - Poznavanje stranih jezika i veština prezentacije predstavnika subjekta koji učestvuju na sajmu, maksimalno deset (10) kumulativnih poena: Engleski jezik pet (5) poena, Nemački jezik četiri (4) poena i drugi jezici jedan (1) poen;
 - Promotivni materijali na stranim jezicima, maksimalno deset (10) kumulativnih poena: na Engleskom jeziku četiri (4) poena, na Nemačkom jeziku četiri (4) poena i dva (2) poena na drugim Evropskim jezicima;
 - Države u kojima su proizvodi aplikanta izvezeni tokom 2019 i 2020, maksimalno deset (10) kumulativnih poena: države članice EU pet (5) poena, države Zapadnog Balkana koje nisu članice EU (Albanija, Bosna i Hercegovina, Srbija, Crna Gora i Makedonija) tri (3) poena i druga tržišta dva (2) poena;
 - Međunarodna sertifikacija aplikanta, maksimalno pet (5) kumulativnih poena: HACCP dva (2) poena, ISO 22000 dva (2) poena i druge relevantne sertifikacije jedan (1) poen;
 - Prezentacija aplikanta na sajmovima u poslednje tri (3) godine, maksimalno pet (5) poena: jedan sajam jedan (1) poen, dva (2) sajmovi dva (2) poena, tri (3) sajmovi tri (3) poena, četiri (4) sajmovi četiri (4) poena i pet (5) i više sajmovi pet (5) poena;
 - Godišnji promet aplikanta tokom fiskalne godine 2020, maksimalno deset (10) poena: od nule do 500.000 evra četiri (4) poena; od 500.001 do 1.000.000 evra osam (8) poena i preko 1.000.000 evra deset (10) poena;

Dana 16.08.2019, u 14:00 časova, u sali za sastanke KIESA, službenici KIESA će odgovoriti na pitanja o sajamskoj organizaciji i podršci kompanijama za učešće na ovom sajmu. Subjektima kojima je potrebna asistencija u popunjavanju ovog obrasca savetuje se da takođe prisustvuju ovom sastanku.

Subjekti koji žele da apliciraju za učešće na sajmu treba da izraze svoje interesovanje popunjavanjem aplikacije i poslati najkasnije do 27.08.2019 u kancelariji Arhive Ministarstva Trgovine i Industrije, Ulica: Arbënor e Astrit Dehari" no. 12, Priština, 10000, Republika Kosovo.

U trenutku apliciranja, subjekat prihvata sve odgovornosti, obaveze, kriterije i dužnosti predviđene važećim zakonima i posebnim kriterijumima predviđenim u ovom javnom pozivu.

Informacije i upitnik za izražavanje interesovanja mogu se dobiti na KIESA-MTI ili preuzeti sa veb stranice mti.rks-gov.net i kiesa.rks-gov.net ili na e-mail adresi export.kiesa@rks-gov.net.

EU TRADE sh.p.k

NUI:811275363

Ferizaj

EU TRADE sh.p.k, me Numër

Unik Identifikues:

NUI:811275363 me seli në

Ferizaj ka marrë vendim të bëjë
zbritjen e vlerës së kapitalit:

Ndryshimet:

1. Zbritja e vlerës së kapitalit te
përgjithshëm të aksionareve nga
550,000 euro ne 43,398.08 euro
Tel.i kontabilistit: 045-367-666

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime
drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Can Maloku Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Adelina Sahatqija Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III, IV dhe diplomën e Q.A. "Hysni Zajmi" Gjakovë.

► Bleona Jetishi Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII dhe diplomën e dhe certifikatën e maturës SH.M. të mjekësisë "Hysni Zajmi, Gjakovë.

► Afrim Morina Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

► Rilil Tetaj Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

► Lionel Tetaj Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

► Vlora Salicana Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e SH.M. Gjmnazi "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Jashar Nivokazi Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. II të SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

► Talat Komoni Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

► Fahrije Balaj Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III, IV të SH.M. msusisë "Hysni Zajmi" Gjakovë, teknike e farmacisë.

► Rrezon Gojani Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X të SH.M. "Kadri Kusari" Gjakovë.

► Qazim Curri Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike drejtimi trikotazh "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

► Teuta Qadraki shpall të pavlefshme dëftesën e kl. Së dhjetë të shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.

► "Your Future Europa" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811559460.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merrret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoh një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në mbështetje të nenit 3 paragrafit 1, nën-paragrafit 1.4 dhe nenit 9 paragrafit 8, nën-paragrafit 8.1 të Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën (GZ/ Nr. 36 / 31 tetor 2016), të nenit 6 paragrafi 2, nenit 19 paragrafit 2, nën-paragrafit 2.11, dhe nenit 22 të Statutit të Trepça Sh.A, të nenit 17 dhe 21 paragrafët 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, (G Z / Nr. 31/15 qershor), si dhe nenit 9 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, G Z/Nr. 13/30 maj 2012, Bordi i Përkohshëm Mbikëqyrës i Trepça Sh.A. me datë 18.08.2021 rishpall:

KONKURS

Pozita: Zyrtar kryesor financiar dhe i thesarit

Vendi i punës: Mitrovicë-Parku Industrial;

I përgjigjet: Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit Mbikëqyrës të Drejtorëve;

Kohëzgjatja e kontratës: Tri (3) vite, me mundësi vazhdimi;

Paga: Në pajtim me deklaratën për politiken e kompensimit të aprovuar nga Bordi Mbikëqyrës i Drejtorëve;

Orari i punës: I plotë

1. Të përgjithshme

Kandidatët për këtë vend pune duhet të jenë persona me integritet, të cilët plotësojnë kushtet e kualifikimit, kriteret e pavarësisë, duhet të kenë përvojë të nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar, dhe kushtet tjera të kërkuara me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën, Statutin e Trepça Sh.A.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Është përgjegjës për zbatimin e të gjitha dispozitave financiare dhe standardeve të kontabilitetit, ligjet e aplikueshme në Kosovë të cilat rregullojnë çështjet financiare dhe aktet normative të ndërmarrjes;
- Organizon, udhëheq dhe kontrollon punën e departamentit financiar;
- Mban përgjegjësi për pagesën e obligimeve financiare në pajtim me rregulloret financiare;
- Mban evidencë dhe dokumentacion të saktë për investimet dhe pagesat e ndërmarrjes;
- Rishikon shpenzimet e të punësuarve për të siguruar pajtueshmëri me politikën e Kompanisë dhe buxhetin para pagesës së tyre;
- Përcjell dispozitat financiare në fuqi dhe literaturën profesionale dhe mban përgjegjësi nëse nuk aplikohen ligjet në fuqi;
- Kujdeset për pasurinë e ndërmarrjes, monitoron punën e komisioneve, kontrollon hyrje -daljet financiare në përgjithësi;
- Përcjell gjendjen financiare në banka dhe bashkëpunon me institucionet bankare dhe organet tjera në interes të ndërmarrjes;
- Është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare periodike dhe përfundimtare;
- Është përgjegjës për përgatitjen e transfereve bankare përkatësisht pagesave me dokumentacion mbështetës dhe siguron KE-në se pagesa është në rregull;
- Harton, zbaton dhe kontrollon zbatimin e procedurave financiare nga vartësit;
- Është përgjegjës të kontrollojë mbajtjen në rregull të arkivit të dokumentacionit të kontabilitetit dhe atij financiar;
- Zhvillon dhe zbaton rregullat e brendshme të kontrollit si dhe udhëzimet dhe procedurat për aktivitete si administrimi i buxhetit, menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve dhe mbajtja e llogarive;
- Është përgjegjës për rregullsinë e proceseve në funksionin e kontabilitetit në kompani, përgatit dhe zbaton procedurat e kontabilitetit sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të kompanisë brenda ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Të përgatis të dhënat e ndërmarrjes për auditim të jashtëm, bashkëpunon me auditorin e jashtëm për çështje të auditimit dhe bënë përpjekje maksimale për zbatimin e rekomandimeve të cilat vijnë si rrjedhojë e një auditimi të brendshëm, të jashtëm ose nga çfarëdo organi tjetër këshillues apo ofruar i sigurisë;
- Mban përgjegjësi për kryerjen e regjistrimeve dhe barazimeve të pasurisë së Ndërmarrjes;

- Përgatit raportet periodike dhe vjetore të Ndërmarrjes për Bordin Mbikëqyrës dhe Bordin Menaxhues.
- Ushtron kujdes për ecurinë e shpenzimeve të Ndërmarrjes sipas planit të biznesit, pagesën e obligimeve Ligjore dhe afarizmin e Ndërmarrjes;
- ZKFTH i raporton KE-së dhe Bordit Mbikëqyrës të Drejtorëve;
- Bashkëpunon me zyrtarët tjerë të Ndërmarrjes siç janë: Kryeshefi Ekzekutiv, Auditori i Brendshëm dhe Sekretari i Korporatës për të ndihmuar ndërmarrjen në arritjen e objektivave të saj;
- Kryen edhe punë të tjera, për të cilat autorizohet nga KE dhe Bordi Mbikëqyrës.

KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE

Një kandidat për t'u zgjedhur në pozitën e Zyrtarit kryesor financiar të Trepça Sh.A, duhet të plotësoj kushtet, të ketë kualifikime dhe përvojë pune sipas nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, si vijon::

- Të posedojë diplomë universitare-Fakulteti ekonomik, nga Fusha e Financave/kontabilitetit. (Ekonomist i diplomuar ose master në shkencë ekonomike);
- Të dëshmoj përvojën menaxheriale, udhëheqëse e profesionale nga fusha e kontabilitetit dhe financave për së paku pesë (5) vite përvojë drejtuese në ndërmarrje publike, institucione lokale ose qendrore apo dhe në ndërmarrje private;
- Të jetë kontabilist i certifikuar, nga një organ i licencuar nga KKRF-ja ose ndërkombëtar ;
- Të ketë njohuri në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar- (SNRF) në bazë të cilave raporton Ndërmarrja;
- Të ketë shkathtësi kompjuterike, posaçërisht mbi sistemet e avancuara në fushën e financave/kontabilitetit;
- Njohja e gjuhëve të huaja do të jetë përparësi për kandidatin;
- Një person ka të drejtë të shërbej në pozitën e Zyrtarit kryesor financiar dhe të thesarit të Trepça Sh.A, nëse plotëson kriteret sipas nenit 17.1, pikat a,b,c,d dhe nenit 21.4 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike
- Nuk mund të zgjidhet në pozitën e Zyrtarit kryesor financiar të "Trepça" Sh.A personi i cili nuk plotëson kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat ,d,f,j,k dhe l dhe nenit 21.4 Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët për pozitën e Zyrtarit kryesor financiar dhe të thesarit të "Trepça" Sh.A duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV-në;
- Letër motivim;
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në vendin e dorëzimit të tyre);
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional si diplomën universitare dhe dëshmi tjera të ngjashme, dëshmi për përvojën e punës, dëshmi nga trusti i kursimeve pensionale);
- Certifikatën (dëshminë) nga gjykata kompetente që dëshmon se nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Aplikuesi duhet të plotësoj personalisht **deklaratën nën betim**, me rastin e aplikimit, në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe të përshtatshmërisë profesionale. Çdo përgënjeshtrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në diskualifikimin e menjëhershëm.

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur ku shkruhet emri dhe mbiemri dhe të dorëzohet në arkivin e zyrave qendrore të Trepça sh.a. në Parkun Industrial në Mitrovicë.

I gjithë dokumentacioni duhet të jetë në formë origjinale ose në kopje të noterizuar. Diplomat universitare të marra jashtë shtetit, duhet të sillen së bashku me vendimin për nostrifikim nga MASHT.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet mund të kërkohen gjatë intervistës.

Për informata shtese:

www.trepvacorporation.com si dhe e-mail adresa: contact@trepvacorporation.com

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Afati i konkursit është i hapur 30 ditë nga data e publikimit në web faqen e Trepça Sh.A. (www.trepvacorporation.com) dhe në shtypin ditor.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Sukladno članku 3. stavku 1. podstavku 1.4. i članku 9. stavku 8. podstavku 8.1. Zakona br. 05/L-120 o Trepçi (GZ/ Nr. 36 / 31 tetor 2016), Članak 6 stavak 2, članak 19, stavak 2, podstavak 2.11 i članak 22. Statuta Trepçe d.d, članak 17. i 22 članak 3 i članak 4. Zakona br. 03 / L-087 o javnim preduzećima, (G / br. 31/15), kao i članak 9. stavak 1. Zakona br. 04 / L-111 o izmjeni i dopuni Zakona br. 03 / L-087 o javnim preduzećima, GZ / Nr. 13. - 30. 2012., Privremeni Nadzorni Odbor Trepçe datum 18.08.2021 ponovo potvrditi:

KONKURS

Pozicija: Glavni direktor za finansije i trezor

Mesto rada: Mitrovica-Industrijski park;

Odgovoran za: izvršnog direktora i nadzorni odbor direktora;

Trajanje ugovora: Tri (3) godine, sa mogućnošću produženja;

Plata: U skladu sa izjavom o politici kompenzacije koju je odobrio Nadzorni odbor;

Radno vreme: Puno radno vrem

1. Generale

Kandidati za ovu poziciju trebaju biti osobe s integritetom koje ispunjavaju kvalifikacijske uvjete, kriterije neovisnosti, moraju imati potrebno profesionalno iskustvo i potrebnu izobrazbu, te druge uvjete propisane odredbama Zakona br. 03 / L-087 o javnim preduzećima, Zakon br. 05 / L-120 o Trepçi, Statut Trepçe d.d.

3. Glavne dužnosti i odgovornosti:

- odgovoran je za sprovođenje svih finansijskih odredbi i računovodstvenih standarda, važećih zakona na Kosovu koji regulišu finansijska pitanja i normativnih akata preduzeća;
- Organizuje, upravlja i kontroliše rad finansijskog odeljenja;
- snosi odgovornost za plaćanje finansijskih obaveza u skladu sa finansijskim propisima;
- Održava tačnu evidenciju i dokumentaciju za investicije i plaćanja preduzeća;
- Preispituje troškove zaposlenih kako bi se osiguralo poštovanje smernica i budžeta kompanije pre njihove isplate;
- Prati finansijske odredbe na snazi i stručnu literaturu i odgovoran je ako se ne primenjuju važeći zakoni;
- Brine o imovini preduzeća, nadgleda rad komisija, kontroliše finansijske prilive i odlive uopšte;
- prati finansijsku situaciju u bankama i saraduje sa bankarskim institucijama i drugim telima u interesu preduzeća;
- odgovoran je za pripremu periodičnih i završnih finansijskih izveštaja;
- odgovoran je za pripremu bankovnih transfera ili plaćanja sa pratećom dokumentacijom i uverava EK da je uplata uredna;
- Dizajnira, sprovodi i kontroliše sprovođenje finansijskih postupaka od strane podređenih;
- odgovoran je za kontrolu pravilnog održavanja arhive računovodstvene i finansijske dokumentacije;
- Razvija i primenjuje pravila interne kontrole, kao i smernice i procedure za aktivnosti kao što su upravljanje budžetom, upravljanje imovinom i pasivom i knjigovodstvo;
- odgovoran je za regularnost procesa u računovodstvenoj funkciji u preduzeću, priprema i primenjuje računovodstvene postupke u skladu sa važećim zakonima na Kosovu, kao i kompetentno upravlja finansijskim resursima kompanije u okviru važećih zakona i propisa;
- Pripremiti podatke preduzeća za spoljnu reviziju, saradivati sa spoljnim revizorom po pitanjima revizije i uložiti maksimalne napore da primene preporuke koje su rezultat interne, eksterne revizije ili bilo kog drugog savetodavnog ili obezbeđenja telesnog obezbeđenja;
- Snosi odgovornost za registraciju i usaglašavanje imovine Preduzeća;
- Priprema periodične i godišnje izveštaje preduzeća za nadzorni odbor i upravni odbor.
- Vežbe brinu o izvršenju troškova preduzeća u skladu sa poslovnim planom, plaćanjem zakonskih obaveza i poslovanjem preduzeća;

- Glavni direktor za finansije i trezor izveštava izvršnog direktora i Nadzorni odbor direktora;
- Saraduje sa drugim službenicima preduzeća kao što su: izvršni direktor, unutrašnji revizor i korporativni sekretar kako bi pomogao preduzeću u postizanju njegovih ciljeva;
- Obavlja druge zadatke za koje je ovlašćena od strane izvršnog direktora i Nadzornog odbora.

KVALIFIKACIJE I PROFESIONALNA DOSTUPNOST

Kandidat koji će biti izabran na poziciju finansijskog direktora Trepçe DD, mora ispunjavati uslove, imati kvalifikacije i radno iskustvo u skladu sa članom 21. Zakona o javnim preduzećima br. 03 / L-087, kako sledi:

I. Da imam univerzitetsku diplomu - Ekonomski fakultet, iz oblasti finansija / računovodstva. (Diplomirani ekonomista ili master ekonomije);

II. Da dokaže menadžersko, menadžersko i profesionalno iskustvo u oblasti računovodstva i finansija za najmanje pet (5) godina menadžerskog iskustva u javnim preduzećima, lokalnim ili centralnim institucijama ili u privatnim preduzećima;

III. Biti sertifikovani knjigovođa, od tela koje ima dozvolu KCFR ili međunarodno;

IV. Imati znanje u tumačenju Međunarodnih računovodstvenih standarda (IAS) i Međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja (MSFI) na osnovu kojih preduzeće izveštava;

V. da poseduju računarske veštine, posebno na naprednim sistemima u oblasti finansija / računovodstva;

VI. Znanje stranih jezika biće prednost za kandidata;

VII. Lice ima pravo da služi na mestu glavnog finansijskog službenika i blagajnika Trepçe dd ako ispunjava kriterijume prema članu 17.1, tačke a, b, c, d i članu 21.4 Zakona br. 03 / L-087 o javnim preduzećima

VIII. Lice koje ne ispunjava kriterijume nezavisnosti prema članu 17.2, tačke, d, f, j, k i l i članu 21.4 Zakona br. Ne može biti izabrano na mesto glavnog finansijskog direktora „Trepča“ a.d. 03 / L-087 o javnim preduzećima.

OPŠTE INFORMACIJE O KANDIDATIMA U VEZI S KONKURNIM POSTUPCIMA

Kandidati za mesto finansijskog direktora i blagajnika „Trepče“ a.d., moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- CV;
- Motivaciono pismo;
- Izjava (obrazac, koji se popunjava u vreme predaje dokumentacije na mestu njihovog podnošenja);
- Dokumentacija data u uslovima zaposlenja (dokazi o profesionalnoj kvalifikaciji kao što su fakultetska diploma i drugi slični dokazi, dokazi o radnom iskustvu, dokazi iz fonda za penzijsku štednju);
- Uverenje (dokaz) nadležnog suda kojim se dokazuje da nije pod istragom ne starije od šest (6) meseci;
- Građanin Kosova (kopija pasoša ili lične karte).

Podnosilac prijave mora lično da popuni izjavu, na osnovu prijave u kojoj se izjašnjava da ispunjava uslove kvalifikacije, nezavisnosti i profesionalne podobnosti. Svako materijalno opovrgavanje, bilo namerno ili iz nehata, ili materijalna promena u odnosu na informacije dane u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Dokumentacija mora biti u zatvorenoj koverti u kojoj su ime i prezime napisana i predata u arhivu centralnih kancelarija Trepca sh.a. u Industrijskom parku u Mitrovici.

Sva dokumentacija mora biti u originalnom obliku ili overena kopija. Univerzitetske diplome stečene u inostranstvu moraju doneti MONT sa odlukom o nostrifikaciji.

Dostavljena dokumentacija se ne vraća. Tokom intervjuja mogu se tražiti originali.

Za dodatne informacije:

vvv.trepacorporation.com i adresa e-pošte: contact@trepcacorporation.com

Biće kontaktirani samo kandidati koji uđu u užu izbor.

Rok za konkurs otvoren je 30 dana od dana objavljivanja na veb stranici kompanije Trepca Sh.A. (vvv.trepacorporation.com) i u dnevnoj štampi.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

